



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE GJIROKASTËR

NOTER SOKOL M. AGO  
ADRESA VAROSH, MELEQ  
GOSNISHTI, NR.5, NR.2, NR.15/89  
TEL: 682282801

## PËRPILIM DHE VËRTETIM TË SH.P.K.-VE

(AKT THEMELIMI DHE STATUT)

Nr. repertori: 168

Nr. koleksioni: 104


Permet më 14/03/2024

Ligjet referuese:

- Ligi nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligi nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale", i ndryshuar
- Ligi nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024021490012067765



## AKT THEMELIMI

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "GILI GM -PERMET" sh.p.k.

Gavril Mamillo, i biri i Paskal, i datelindjes 28.01.1967, lindur ne Stebleve dhe banues ne Permet ,madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me letërnjoftimi 037376467,te date leshimi 23.06.2021 dhe nr personal G70128186N.

Si themelues i shoqërise "GILIGM -PERMET" sh.p.k., si ortak i vetem i shoqërisë dhe Administrator i shoqërisë, vendosi të hartojnë këtë Akt Themelimi ,për krijmin e kësaj shoqërie, mbështetur në parimet e mëposhtme :

#### Neni 1

Themeluesi me anën e këtij Akt Themelimi dhe të Statutit të shoqërisë krijon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të cilën do ta emërtojë " GILIGM- PERMET " sh.p.k.

#### Neni 2 SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqërisë është në adresën : Qyteti Përmet, Lagjia Bajame. Shoqëria mund të ketë filiale, Degë dhe perfaqësi të saj edhe në qendra të tjera të territorit të Republikës së Shqipërisë ,si dhe jashtë territorit të Shqipërisë, ku ajo ushtron aktivitetin e saj, pas miratimit nga organet kopetente shtetërore.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakut të vetem. Në këtë rast do të njoftohen organet e tatim taksave, për selinë e re të shoqërisë.

#### Neni 3 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objktivi i veprimtarisë së shoqërise do të jetë:

Ushtrimi e aktivitetit Privat, në fushën e trasportit të njerëzve dhe bagazheve të tyre në linjat Kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe ngritjen e agjensive të udhetimit.

Transport turistike i udhetareve brenda vendit, guida turistike brenda vendite etj.

Tregëtim pjesë këmbimi, pajisjeve elektrike dhe elektronike, Servis Makinash, Lavazho, Tregëtimi i artikujve ushqimor dhe industriale, si dhe transportimi i tyre brenda dhe jashtë vendit

#### Neni 4 KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqëria ka një kohëzgjatje të veprimtarisë së saj mbi 10 vjet. Ajo mund të përfundojë veprimtarinë e saj përpala këtij afati në rastet e prishjes ose likuidimit të shoqërisë të parashikuara këto sipas ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008 "Për Shoqëritë Tregëtare" . Për prishjen ose likuidimin e saj, shoqëria do të zbatojë procedurat e përcaktuar sipas ligjeve në fuqi.

#### Neni 5



## KAPITALI THEMELTAR

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) lekë, kapital i depozituar ne banke i vërtetuar me vertetimin përkatës të lëshuar nga banka .

- a- Z.Gavril Mamillo eshte zotrues i 1 kuote me vleren 100000 (Njeqinde mijë) leke ku perfaqeson 100% te vleres se Kaptiralit Themeltare te shoqerise "GILIGM -PERMET " sh.p.k.

### Neni 6

Kuotat e Kapitalit themeltar të zotëruara nga të ortaku vetem, janë lirisht të trasferueshme në rrugë trashgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në raste ndarje pasurore mes bashkëshorteve. Gjithashtu janë lirisht të trasferueshme ndërmjet bashkëshortëve si dhe ndërmjet pasardhësve e paraardhësve të tyre.

### Neni 7

## STEMA DHE VULA E SHOQERISE

Shoqëria ka stemën dhe vulen e saj. Stema e shoqërisë krijohet me vendim të ortakut të shoqërise. Ne vule shkruhet :

"**GILIGM- PERMET** " sh.p.k"

Çdo ndryshim i vulës së shoqërise, bëhet nga ortaku i vetem , me vendim të veçantë të tij i cili legalizohet dhe depozitohet, në Regjistrin Tregtar.

Çdo shkresë e dokumentuar dhe lëshuar ,nga perfaqësuesi i kësaj shoqërie, që të jetë e vlefshme duhet pasi të nënshkruhet nga përsoni kopotent dhe të vuloset me vulën e shoqërisë.

### Neni 8

Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij Akti Themelues edhe me dispozitat e Statusit të saj, të cilat pasi nënshkruhen nga ortaku përpara noterit, më pas do të miratohen si përson juridik në Shqipëri. (QKR)

Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen nga ky Akt Themelimi dhe Statuti përkatës, do të vleinë dispozitat e ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008 "Për Shoqërite Tregtare" seksioni për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, që kanë të bëjnë me funksionimin sa me mirë të shoqërisë, të cilat do të rregullojnë mbarevajtjen e veprimtarisë së kësaj shoqërie.

### Neni 9

Ky akt themelimi është hartuar në 4 kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila kopje fuqi të njejtë ligjore..

Kopjet e tjera do të qëndrojnë në selinë e shoqërisë si dokument themeltar i shoqërisë.

Ky Akt Themelimi pasi u gjet sipas vullnetit të themeluesit u nënshkrua përsonalisht prej ortakut .

Ky akt Themelimi u hartua sot me date 14.03.2024

ORTAKU THEMELUES  
Z. Gavril Mamillo  
G.M.



A2024021490012067765

## STATUTI

### I SHOQËRISE "GILIGM- PERMET " SH.P.K.

#### I. KRIJIMI, FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA DHE KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

##### NENI 1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar " GILIGM- PERMET " me qendër në Përmet , krijuar sipas aktit të themelimit që i bashkalidhet ky statut i përpiluar dhe i nënshkruar nga:

Gavril Mamillo i biri i Paskal ,i datelindjes 28.01.1967, lindur ne Stebleve dhe banues ne Permet , madhor me zotesi te plete per te vepruar.me nr personal G70128186N

##### NENI 2

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë tregtare në Shqipëri në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe në përputhje me dispozitat e këtij statuti, ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtaret dhe shoqërите тregetare", bazuar ne nenin 230 te ketij Kodi (përshtatin organizimin dhe funksionimin e tyre, sipas dispozitave të këtij ligji, brenda 3 vjetëve te shoqerive qe kane fuksionuar para hyrjes ne fuqi te ligjit 9901 date 14.04.2008) në ligjin 9723, datë 03.05.2007 "Për qendrën kombëtare të regjistrimit".

Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit të saj.

##### Neni 3

Emri i shoqërisë është "GILIGM- PERMET " sh.p.k.

##### Neni 4

Objktivi i veprimitarise së shoqërise do të jetë:

Ushtrimin e aktivitetit Privat, në fushën e trasportit të njerëzve dhe bagazheve të tyre në linjat Kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe ngritjen e agjensive të udhetimit.

Transport turistike i udhetareve brenda vendit, guida turistike brenda vendite etj.

Tregëtimi pjesë këmbimi, pajisjeve elektrike dhe elektronike, Servis Makinash, Lavazho, Tregëtimi i artikujve ushqimor dhe industriale, si dhe transportimi i tyre brenda dhe jashtë vendit

##### NENI 5

Qendra e shoqërisë është në Permet ,Lagjja Bajame , ajo mund të hapë filiale në të gjitha rrjetet e vendit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. shoqëria ka vulën e saj me emrin e saj.

##### NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar për një periudhë kohe mbi 10 vjet, duke filluar nga dita e regjistrimit te saj. Kjo periudhë mund të shkurtohet në rast se shoqëria prishet para kohe .

#### II. KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTI,



A202402149001206776

**PJESET E KAPITALIT THEMELTAR.  
NENI 7**

-Kapitali Themeltar i shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) lekë, kapital i depozituar ne banke i vërtetuar me vertetimin përkatës të lëshuar nga banka .

- a- Z.Gavril Mamillo eshte zotruesh i 1 kuote me vleren 100000 (Njeqinde mijë) leke ku perfaqeson 100% te vleres se Kaptiralit Themeltare te shoqerise "GILI GM -PERMET " sh.p.k.

**NENI 8**

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi i ortakut vetem .

**NENI 9**

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashegimie, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve dhe nëpërmjet para ardhësve dhe pasardhësve.

**NENI 10**

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë me miratimin e ortakut vetem

**NENI 11**

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar gjithmonë duhet të vërtetohet me Akt Notarial.

**III. MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI,  
KOPETENCA DHE KONTROLI  
I SHOQERISE**

**NENI 12**

Të gjitha vendimet e shoqërise merren nga ortaku vetem .

**NENI 13**

Shoqëria administrohet nga administratori ,që duhet të jetë person fizik ,ose mund të jetë ortaku i vetem Në mbledhjen e parë të shoqërisë, emërohet administrator Gavril Mamillo

Administratori emërohet dhe shkarkohet me miratim të ortakut vetem .

Emerimi i tij bëhet për 3(tre) vite financiare ,me përjashtim të rasteve të dorëheqjes, ose të shkarkimit përfshirë.

**NENI 14**

Administratori është përgjegjës individualisht ose solidarisht sipas rastit, ndaj shoqërise apo të tretëve për shkelje të ligjeve, të dispozitave të këtij statuti, apo përfshirë gjatë administrimit të shoqërisë.



A2024021490012067765

### NENI 15

DISA NGA KOPETENCAT QË I JEPEN ADMINISTRATORIT JANE:

Të sigurojë drejtimin e mirë të shoqërisë.

Të sigurojë pasurinë e shoqërisë.

Të përfaqësojë shoqërinë në marëdhëniet me të tretët.

Të përfaqësojë shoqërine para organeve gjyqësore ose autorizon persona të tjera kopetent.

Kryen veprime juridike në emër dhe për llogari të shoqërisë me të tretët si: lidh kontrata, bën çeljen e kredive, kryen veprime të ndryshme bankare dhe brenda limitit që lejohet nga ortaku.

### NENI 16

Kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël, i cili emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakut vetem.

## IV .VITI FINANCIAR DHE LLOGARITE VJETORE

### NENI 17

Çdo vit finansiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përashtimisht viti i parë ka filluar ditën e themelimit si përson juridik.

### NENI 18

Llogarite vjetore, inventari, raporti mbi veprimitarinenë financiare të hartuara nga administratori, nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohet nga ortaku i vetem.

### NENI 19

Bilanci vjetor i veprimitarisë së shoqërisë nxirret brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës.

### NENI 20

Fitimet neto të realizuara nga veprimitaria e shoqërisë, pasi zbriten të gjitha shpenzimet e kryera, ortaku vetem vendos për qëllimin e përdorimit si: për investim, nxitjen ekonomike, reklamat tregëtare etj.

### NENI 21

Shoqëria ka të drejtën e përdorimit lirisht të fitimeve dhe të disponimit lirisht të pasurisë së saj, në përputhje me qëllimin e objektit të veprimitarisë që kryen.

### NENI 22


Detyrimet që lindin gjatë veprimitarisë së shoqërisë ajo i mbulon nga fondi rezervë ose shumat suplementare.

### NENI 23



A202402149001206765

Shoqëria mbron të gjitha të drejtat dhe bën mbrojtjen e pasurisë së saj nga legjislacioni shqiptar në fuqi.



## V . PUNËSIMË NË SHOQËRI

### NENI 24

Për punonjësit, që do të punësohen në marrëdhënet juridike midis shoqërisë dhe të punësuarve do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

### NENI 25

Shoqëria merr përsipër të derdhë të gjitha detyrimet rregullisht, gjithashtu edhe kontributet për sigurimin e të punësuarve të saj në organet kopetente përkatëse, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

## VI. PRISHJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI

### NENI 26

Shoqëria prishet para kohe kur:

- aktiviteti ekonomik i saj për disa vjet radhazi është me humbje
- për arsyet e parashikuara me ligj
- në çdo rast me vendim të ortakut vetem

### NENI 27

Shoqëria hyn në proçesin e likudimit që në momentin e marrijes së vendimit për prishjen e saj. Për kryerjen e këtij proçesi , ortaku emëron një ose dy likudatorë , të cilët paraqesin raportin mbi gjendjen e aktivitit dhe pasivit të shoqërisë.

## VII .KUSHTET E TJERA

### NENI 28

Të gjitha vendimet e ortakut vetem, regjistrohen në libër të veçantë, që mbahet në selinë e shoqërisë.

### NENI 29



A2024021490013067763

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk zgjidhen me mirëkuptim , organi këpëtent për zgjidhjen e tyre është Gjykata.

**NENI 30**

Ky statut është hartuar në qytetin e Përmetit sot me datë 14.03.2024

**ORTAKU**

**Gavril Mamillo**

*Gavril Mamillo*  
*G.M.*



*[Large blue signature over a faint circular watermark]*



## DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Unë Noteri verifikova identitetin e **THEMELUES/IT**: Gavril Mamillo, atësia Paskal, amësia Ollga, shtetas Shqiptar, lindur në Stebleve, Dibër dhe banues në PËRMET, me adresë Demokracia 02240015; Nd. 19; H. 1; Përmet; Përmet; 6401; Përmet, lindur më 28/01/1967, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037376467 dhe nr. personal G70128186N nëpërmjet dokumentit të identitetit dhe pasi e gjeta përbajtjen e aktit notarial të mësipërm, në përpunohet të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**THEMELUES/IT**

Gavril Mamillo

*Gavril Mamillo*  
*G*

